

RREGULLORE NR. 1999/22

UNMIK/RREG/1999/22

15 nëntor 1999

PËR REGJISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NE KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të regjistrimit të organizatave joqeveritare dhe rregullimin e veprimtarive të tyre në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1

FUSHËVEPRIMI I RREGULLORES

1.1 Kjo rregullore rregullon themelimin, regjistrimin, veprimtaritë dhe shpërndarjen e personave juridikë të organizuar si organizata joqeveritare në Kosovë,

1.2 Termi Organizatë Joqeveritare (OJQ), siç përdoret në këtë Rregullore, përfshin shoqatat dhe fondacionet e vendit si përcaktohet në nenin 2 të kësaj Rregulloreje, si edhe organizatat ndërkombëtare dhe të huaja si përcaktohet në nenin 3. Kjo rregullore nuk kërkon kufizim të të drejtës së personave për t'u organizuar në shoqata.

1.3 OJQ nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën dhe nuk përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, nëpunës, anëtar, punonjës ose donatorë të OJQ-së. Ky nen nuk pengon pagesën a kompensimin e arësyeshëm për personat që e kryejnë punën për për organizatën.

Neni 2

KRIJIMI I SHOQATAVE DHE I FONDACIONEVE NË KOSOVË

2.1 Një OJQ vendase është një shoqatë ose fondacion i krijuar në Kosovë për të përmbushur qëllime të ligjshme, si për përfitim publik ose për interes të ndërsjelltë.

2.2 Shoqata është një organizatë anëtare që përbëhet nga anëtarët e saj. Një shoqatë mund të krijohet nga të paktën tre persona juridikë ose fizikë ("Persona"), vendës ose të huaj, kur të paktën njëri prej tyre ka një rezidencë ose zyrë në Kosovë.

2.3 Fondacioni është organizatë pa anëtarë, i krijuar për të administruar prona dhe pasuri. Një fondacion mund të krijohet nga një ose më shumë persona kur të paktën njëri prej tyre ka vendbanim ose zyrë në Kosovë.

2.4 Shoqata ose fondacioni krijohet në bazë të dokumentit të themelimit që duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

1. emrin zyrtar të organizatës dhe çdo emërtime zyrtar me inciale;
2. formën organizative(shoqatë ose fondacion);
3. adresën e organizatës;
4. qëllimin e organizatës;
5. emrat dhe adresat e themeluesve dhe
6. emrin, adresën dhe informata tjera kontaktimi me personin ose personat në Kosovë të autorizuar për të përfaqësuar organizatën, për të marrë njoftime dhe kërkesa zyrtare.

2.5 Fondacioni mund të krijohet me testament dhe me lënie trashëgim me kusht që të përmbajë informatat e parapara në paragrafin 2.4.

2.6 Shoqata ose fondacioni duhet të hartojë statutin e tij/saj i cili duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

emrin e organizatës;

qëllimet e organizatës dhe një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve të propozuara;

nëse OJQ është një shoqatë, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve, kushtet për anëtarësim, dhe, nëse organizata vendos të ketë një bord, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të bordit dhe caktimin e kompetencave e përgjegjësive për asamblenë e përgjithshme të anëtarëve dhe bordin;

nëse OJQ është fondacion, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të bordit;

kompetencat e organit më të lartë drejtues për t'i deleguar autorizime dhe përgjegjësi organeve të tjera të brendshme të OJQ-së dhe procedurat për këtë delegim;

kompetencat dhe përgjegjësitë e nëpunësve, nëse ka;

kuorumin dhe rregullat e votimit për organin më të lartë drejtues dhe për cdo organ tjetër të brendshëm të OJQ;

rregullat dhe procedurat për ndryshimin e statutit dhe për bashkimin, ndarjen ose shpërbërjen e organizatës dhe dispozitat lidhur me shpërndarjen e pasurive të mbetura pas shpërbërjes.

-

Neni 3

OJQ-të E HUAJA DHE NDËRKOMBËTARE

3.1 OJQ-ja e huaj ose ndërkombëtare është person juridik i krijuar jashtë Kosovës sipas legjislacionit që përmbush në thelb kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3.2 të kësaj rregulloreje.

3.2 OJQ-të e huaja dhe ndërkombëtare i nënshtrohen dispozitave të neneve 1, 3, 4.1, 4.3, 4.4, 4.5, 4.6, 5, 6.2, 8 dhe 9 deri 14 të kësaj rregulloreje.

-

Neni 4

REGJISTRIMI

4.1 Një OJQ shtron kërkesë për t'u regjistruar në UNMIK në mënyrë që të veprojë si person juridik në Kosovë.

4.2 Një fondacion ose shoqatë regjistrohet duke dorëzuar në UNMIK një kërkesë-formular, dokumentin e themelimit dhe statutin e tij/saj.

4.3 Një OJQ e huaj ose ndërkombëtare regjistrohet duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

- (a) një kërkesë-formular;
- (b) dëshminë që është person juridik në një vend tjetër;
- (c) adresën e organizatës në Kosovë dhe
- (d) një deklaratë me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i drejtorisë së OJQ-së që tregon:
 - (1) qëllimin e OJQ-së;
 - (2) një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve që OJQ-ja ka planifikuar të kryejë në Kosovë dhe
 - (3) emrin, adresën dhe informacion tjetër kontakti të personit ose personave në Kosovë të autorizuar të përfaqësojnë OJQ-në dhe të marrin njoftime dhe kërkesa zyrtare.

4.4 Për çdo ndryshim të rëndësishëm në lidhje me dokumentet e paraqitura për regjistrim. Ndryshimet në regjistrim, OJQ-ja duhet të informojë në UNMIK brenda tridhjetë (30) ditësh pune janë subjekt i procedurave, standardeve dhe afateve të njëjta me ato të kërkuara për regjistrimin fillestar. Ndryshimet e pranuar nga UNMIK-u mbahen, regjistrohen dhe vihen në dispozicion të publikut sipas paragrafit 4.5 të kësaj rregulloreje.

4.5 UNMIK-u duhet të mbajë një regjistër për OJQ-të. Në regjistër tregohet emri, adresa, forma e organizimit dhe qëllimet e çdo OJQ-je, si edhe emri, adresa dhe informacioni tjetër i kontaktit të përfaqësuesit/përfaqësuesve të saj të autorizuar. Regjistri gjithashtu duhet të tregojë nëse një OJQ ka status të privilegjuar publik sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje. Regjistri i vihet në dispozicion publikut në një vend qendror gjatë orëve të rregullta të punës të përcaktuar nga autoriteti regjistruar.

4.6 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të punës nga data e marrjes së kërkesës për regjistrim, UNMIK ia lëshon OJQ-së certifikatën e regjistrimit ose një vendim me shkrim që e refuzon regjistrimin, nëqoftëse UNMIK nuk kërkon me shkrim informacion ose sqarime të mëtejshme. Nëse regjistrimi refuzohet, UNMIK-u jep shpjegim të arsyeve mbi të cilat regjistrimi është refuzuar.

Neni 5

ARESYET PËR REFUZIMIN E REGJISTRIMIT

5.1 UNMIK-u mund të refuzojë një kërkesë në qoftë se:

- (a) Dokumentet e regjistrimit biejnë në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje;
- (b) Në qoftë se statuti i OJQ bie në kundërshtim me dispozitat e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) ose me ndonjë rregullore tjetër të UNMIK-ut dhe
- (c) Organizata që kërkon regjistrimin ka të njëjtin emër ose një emër shumë të ngjashëm me një

OJQ të regjistruar ose të krijuar më pare, gjë që mund të sjellë konfuzion.

5.2 UNMIK-u mund të pezullojë ose revokojë një regjistrim për shkelje të ndonjë dispozite të kësaj rregulloreje. Përveç rasteve të shkeljeve serioze që rrezikojnë apo dëmtojnë publikun, UNMIK-u i dërgon OJQ-së njoftim me shkrim për shkeljen e dispozitave dhe i jep mundësi për t'u përgjigjur para se të pezullojë ose revokojë regjistrimin.

Section 6

STATUSI LIGJOR

6.1 Në bazë të regjistrimit të bërë sipas kësaj rregulloreje, OJQ-të në Kosovë gëzojnë statusin e personit juridik,

6.2 Në bazë të regjistrimit, OJQ-të e huaja dhe ndërkombëtare janë të autorizuara të veprojnë si person juridik në Kosovë.

Neni 7

DREJTIMI I BRENDSHËM I SHOQATAVE DHE I FONDACIONEVE

7.1 Organi më i lartë drejtues i një shoqate është asambleja e anëtarëve. Asambleja përbëhet nga gjithë anëtarët e shoqatës.

7.2 Organi më i lartë drejtues i një fondacioni është bordi i drejtorëve. Bordi i drejtorëve përbëhet nga të paktën tre anëtarë.

7.3 Organi më i lartë drejtues ka përgjegjësi të plota për çështje të politikës dhe financave të organizatës dhe takohet të paktën një herë në vit, në mbledhjen ku shqyrtohen dhe miratohen kapitali qarkullues (aktiv), detyrimet (pasiv), të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar si edhe kapitali qarkullues e detyrimete e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.

7.4 Anëtarëve të organit drejtues nuk u lejohet të marrin pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes personal ose financiar. Çdo transaksion ndërmjet organizatës dhe anëtarëve, nëpunësve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj duhet të kryhet me vlerën e tregut ose në kushte më të favorshme për organizatën.

Neni 8

AKTIVITETET POLITIKE

OJQ-të nuk mund të angazhohen në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike dhe as nuk mund të propozojnë, regjistrojnë ose mbështesin ndonjë kandidatë për funksione publike.

Neni 9

PASURIA DHE BURIMET

9.1 Të ardhurat e një OJQ-je mund të përfshijnë donacione në para, në letra me vlerë dhe kontribute në natyrë; trashëgimi; kuotat e anëtarësimit; dhurata; pasuri të patundshme ose personale dhe të ardhura të krijuara nga aktivitete të ligjshme të ndërmarra nga OJQ-ja me pasurinë dhe burimet e saj.

9.2 Një OJQ mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të

saj jofitimprurëse që janë subjekt i kërkesave të paragrafit 1.3.

9.3 Një OJQ mund të ketë në pronësi dhe të administrojë prona dhe pasuri për përmbushjen e qëllimeve të saj jofitimprurëse.

Neni 10

PËRFITIMET TATIMORE DHE FISKALE

10.1 Subjekt i kufizimeve të përshkruara në paragrafin 10.2 më poshtë, një OJQ e regjistruar sipas kësaj rregulloreje mund të kërkojë statusin për përfitime publike në qoftë se OJQ-ja është organizuar dhe strukturuar për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve të mëposhtëme si aktivitete të saj kryesore: ndihma humanitare dhe ndihma në raste fatkeqsisht, bëmirësi, arësim, shëndet, kulturë, mbrojtje ose ruajtje të mjedisit, rindërtim dhe zhvillim ekonomik, nxitje të të drejtave të njeriut; nxitje të parimeve demokratike dhe të shoqërisë civile, nxitje të barazisë gjinore ose të çdo aktiviteti tjetër që i shërben përfitimit publik.

10.2 Arsimi dhe shëndeti përbëjnë aktivitete të përfitimit publik vetëm në qoftë se për grupe ose persona në nevojë ofrohen shërbime të rëndësishme falas ose me çmim më të ulët se vlera e tregut. Zhvillimi ekonomik përbën aktivitete të përfitimit publik vetëm nëse ndërmerret kryesisht në përfitim të grupeve ose personave në nevojë.

10.3 Një OJQ mund të kërkojë të gëzojë statusin për përfitim publik kur bëhet regjistrimi fillestar nga OJQ-ja ose edhe më vonë. UNMIK-u jep statusin për përfitim publik nëse dokumentet e regjistrimit të OJQ-së tregojnë se qëllimet dhe aktivitetet e OJQ-së përmbushin kërkesat e paragrafit 10.1. Për të përfituar statusin për përfitim publik, OJQ-ja përgatit raporte të aktivitetit dhe raporte financiare sipas direktivave administrative të nxjerra nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

10.4 Për shkeljen e kësaj dispozite, OJQ-së UNMIK-u mund t'ia revokojë ose ndërpres statusin e beneficuar publik. Me rastin e dhënies dhe revokimit të statusit të beneficuar publik duhet të respektohen dispozitat përkatëse të paragrafëve 4.6 dhe 5.2 të kësaj rregulloreje.

10.5 Në përputhje me kushtet dhe procedurat e direktivave administrative të nxjerra nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, OJQ-të me status për përfitim publik gëzojnë të drejtën e lehtësive tatimore dhe fiskale, duke përfshirë përjashtimet nga detyrimet doganore, tatimi mbi shitjen dhe tatime të tjera me përjashtim të pagesave që para se gjithash janë pagesa për shërbime komunale.

Neni 11

SHPËRBËRJA

11.1 OJQ-ja mund të shpërbëhet vullnetarisht në bazë të vendimit të marrë nga organi më i lartë drejtues.

11.2 Në rast të shpërbërjes së një OJQ-je që ka gëzuar përfitime tatimore dhe fiskale, donacione nga publiku ose ndihma financiare nga qeveria, të gjitha pasuritë e mbetura pas shlyerjes së detyrimeve financiare të OJQ-së do t'i jepen një OJQ-je tjetër me të njëjtin qëllim ose me qëllime të ngjashme. Kjo OJQ identifikohet në statutin e OJQ-ve ose me një vendim të organit të saj më të lartë drejtues; në raste të kundërta UNMIK-u vendos për këtë.

11.3 Pasuritë e mbetura pas shlyerjes së detyrimeve shpërndahen në përputhje me statutin ose me një vendim të organit më të lartë drejtues dhe në gjitha këto raste veprohet sipas paragrafit 1.3 të kësaj rregulloreje.

11.4 UNMIK-u duhet të fshijë OJQ-të e shpërbëra nga regjistri i OJQ-ve aktive.

Neni 12
ZBATIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë direktiva dhe urdhra administrativë për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 13
LGJII NË FUQI

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë në legjislacionin në fuqi lidhur me regjistrimin dhe veprimtarinë e organizatave joqeveritare në Kosovë që bien në kundërshtim me të.

Neni 14
HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 1999.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm